

e Miloš Radunovićit dhe Slobodan Radoševićit përskaq rrugës, në hyrje të fshatit Das-hinoc/Daşinovac. Gjashtë vjet më vonë, patologët e Institutit për Mjekësinë Ligjore në Beograd e kanë bërë autopsinë e mbe-tjeve mortore të tyre dhe kanë konstatuar se Slobodani ishte vrarë me një plumb në kokë, ndërkaq nuk ishte e mundur të kon-statohen shkaqet e vdekjes së Milošit.

Burimet: ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=Pravdal-Reforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=Pravdal-Reforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-);) deklarata M.R, FDH-12243; deklarata N.V, FDH-27350; deklarata N.V, FDH-31724; SMIP, *Teroristički...*, III, 904; deklarata N.A, FDH-12060; deklarata N.V, FDH-5566; deklarata U.L, FDH-12384; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 57; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; Z. Stijović, *Kosmet...*, 107; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oružanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDP-20114.

Haxhi (Mustafë) Tolaj

(24.10.1960, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Sadri (Azem) Latifaj

(24.04.1964, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, punëtor, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Edmond (Hysen) Dabiqaj

(2.10.1976, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, tekniku mekanik, pjesëtar i UÇK-së)

Sadriu e kishte kryer shërbimin ushtarak në UJ në Pançevë. Gjatë shërbimit, atë e arrestuan dhe e dënuan me katër muaj burgim për shkak të qëndrimeve të tij politike. Pas skadimit të dënimit, ai ishte i detyruar që ta kryente shërbimin ushtarak deri në fund. Pas kthimit në Kosovë, i ka nisur studimet në Shkollën e Lartë Komerciale, por u detyrua që t'i ndërpriste ato sepse policia e shqetësonte shpesh me thirrjet për biseda informative. U punësua në Ujës-jellësin e Qytetit në Deçan/Deçane. Në datën 18.04.1998, Sadriu aderoi në UÇK.

Haxhiu u bë pjesëtar i UÇK-së më

18.04.1998 në shtabin në Prilep. Por, edhe përpara aderimit zyrtar në UÇK, ai kishte shkuar disa herë në Shqipëri për armatime.

Edmondi hyri në UÇK më 20.04.1998, po ashtu pranë shtabit të Prilepit/Prilep. Ishte përgjegjës për furnizimin e ushtrisë.

Në datën **27.04.1998**, Haxhiu, Sadriu dhe Edmondi u nisën nga Shqipëria për në Kosovë me një ngarkesë armatimesh. Në vendin e quajtur *Podi i Gështenjave/Dolina kestenova* [Voksh/Vokša] ata ranë në pusi të forcave serbe. Që të tre u vranë në vend. Haxhiu, Sadriu dhe Edmondi prehen sot në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Prilep.

Burimet: deklarata H.M FDH-18696; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 106, FDH-23816.

Bilall (Idriz) Mazrekaj

(29.10.1972, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Bilalli jetonte me familjen në fshatin Drenoc/Drenovac. Në datën **29.04.1998**, ai ka shkuar së bashku me nënën, vëllain, bashkëshorten, axhët dhe djemtë e tyre në ceremoninë e varrimit të tre djelmohave, pjesëtarëve të UÇK-së, në fshatin Prilep [të shikohet regjistrimi më lartë]. Gjatë kthimit nga varrimi, në udhëkryqin e fshatit **Drenoc/Drenovac** dhe pranë rrugës Gjakovë/Đakovica - Deçan/Dečane, ata kanë hasur në policinë serbe. Pa kurrfarë paralajmërimi, policët shtënën mbi Bilallin dhe e plagosën atë. Kur ai ra në tokë, një nga policët u afrua dhe sërish shtëni mbi Bilallin e plagosur dhe të shtrirë në tokë. Pas tërheqjes së policisë nga vendi i vrasjes, vëllezërit e Bilallit e kanë çuar trupin e tij të pajetë në shtëpinë familjare. Të nesërmen, më 30.04.1998, e kanë varrosur në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata H.M, FDH-18696; deklarata M.B, FDH-12060; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 106, FDH-23816; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.